



UNIVERSITETI
ILLYRIA



BASHKIA TIRANË

3048/2

Nv. 280/1

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MES
BASHKISË TIRANË
DHE SHKOLLËS SË LARTË JO PUBLIKE ILLYRIA

Bashkia Tiranë dhe Universiteti në vijim të quajtura Palët

Duke vlerësuar rëndësinë e procesit të decentralizimit, si një mekanizëm thelbësor i demokratizimit të vetë shtetit;

Duke konsideruar se procesi i decentralizimit në vetvete është një proces, përsosmëria dhe perfeksionimi i të cilit është një qëllim në vetvete, reformimi konkret i të cilit duhet paraprirë nga studime të mirëfillta shkencore, në aspektin politik, juridik e ekonomik;

Duke konfirmuar vullnetin dhe angazhimin maksimal për të siguruar dhe zbatuar të gjitha mjetet e nevojshme ligjore dhe ekzekutive për zhvillimin e këtyre studimeve shkencore dhe për t'i kthyer ato në një mjet efikas përgjatë proceseve shumë planëshe të decentralizimit të pushtetit;

Duke afirmuar vullnetin e mirë dhe vendosmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në funksion të realizimit të qëllimit të këtij memorandumi;

Duke u mbështetur në kuadrin e plotë ligjor që normon veprimtarinë e tyre institucionale dhe administrative: në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", në ligjin nr. 9741, date 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë";

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi, në vijim i quajtur Memorandumi.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i memorandumit është bashkëpunimi midis Shkollës së Lartë jo Publike Illyria dhe Bashkisë së Tiranës në kuadër të zhvillimit të Projektit Rajonal për Nxitjen e Kërkimit – RRPP (Regional Research Promotion Programme), me temë: “Decentralizimi politik dhe administrativ dhe marrëdhëniet e tij me zhvillimet ekonomike”.

Neni 2

Forma e bashkëpunimit

Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi realizohet nëpërmjet:

- i. Bashkërendimit në dhënie e informacionit përgjate procesit të realizimit të studimit shkencor të mësipërm.;
- ii. Pjesëmarrjes në grupin përkatës të punës që do ngrihet në kuadër të projektit;
- iii. Përdorimi i gjetjeve dhe konkluzione që do të rezultojnë prej studimit për çfarëdo interesi të ligjshëm të secilës palë.

Neni 3

Përgjegjësitë e Palëve

1. Universiteti Illyria merr përsipër të përmbushë gjithë detyrimet e marrëveshjes për projektin konkretisht dhe për çdo fushë tjetër në të ardhmen për të bërë të mundur një bashkëpunim efektiv dhe sa më të frytshëm për të dy institucionet.
2. Të vendosë të gjithë studimin përfundimtar në disponim të Bashkisë Tiranë me qëllim përdorimi prejsaj në masën dhe mënyrën që ajo e vlerëson si të dobishme për të.

3. Bashkia Tiranë merr përsipër, të ofrojë, për nevoja të realizimit të projektit, të informacioneve përkatëse në bazë të kërkesave, dhe të vendosë një person kontakti si pjesë e grupit e punës që do ngrihet në kuadër të projektit.

Neni 4

Komunikimi mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm përpërbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike. Në çdo rast të paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 10 ditëve.
2. Palët, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e memorandumit, caktojnë një person kontakti që është përgjegjës për shkëmbimin e informacionit dhe të kërkesave të palëve në zbatim të memorandumit.
3. Personat e kontaktit janë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me palën tjetër me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

Neni 5

Kostot financiare

Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i këtij Memorandumi i nënshtrohen legjislacionit në fuqi dhe janë përgjegjësi e Universitetit Illyria.

Neni 6

Afati dhe ndryshimi i Memorandumit

Ky memorandum lidhet pa afat dhe mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandum zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 8

Hyrja në Fuqi


Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Bashkinë Tiranë dhe dy në Universitetin Illyria.

Ky Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet sot në Tiranë, më datë _____.

Universiteti ILLYRIA

Presidenti i Universitetit



Bashkia Tiranë

Krytari i Bashkisë

